

# ARGUMENTUM

news opinion analysis



## EKSKLUZIVE

**Ambasadori i Kroacisë në Shqipëri,  
Z. Zlatko Kramarić: Miqësia,  
marrëdhëniet tona të mira politike  
duhet të vërtetohen me veprimtari  
konkrete, jo me fjalë!”**

-A mund të sigurojë Brukseli një paqe të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor?

- Vizita zyrtare Kryeministri Rama pritet nga kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Rishi Sunak

- Saudi Arabia and Iran restore diplomatic ties in China mediated talks held in Beijing

## Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

**Marjana DODA**  
Kryeredaktore

## Përmbajtja

### 03 EKSKLUZIVE

- Ambasadori i Kroacisë në Shqipëri, Z. Zlatko Kramaric: Miqësia, marrëdhëniet tona të mira politike duhet të vërtohen me veprimtari konkrete, jo me fjalë!”

### 07 JO VETËM LAJM

- Ambasadori i Kinës Z. Zhou Ding mbyll mandatin e tij në Shqipëri: Miqësia tradicionale e dy popujve tanë është thesari i përbashkët dhe themeli për zhvillimin afatgjatë të marrëdhënieve dypalëshe.

- Takimi i 12-të i Këshillit të Stabilizim-Asociimit në Tiranë, BE: Shqipëria progres në reforma. Duam të zbatojmë në Shqipëri 10 projektet kryesore.

- 15 vite nga “Gërdeci”/ Humbën jetën 26 persona, u plagosën 300 të tjerë.

### 14 POLITIKË

- Vizita zyrtare e presidentit austriak/ Begaj: Austria mbështet integrimin e Shqipërisë në BE.

- Kryeministri Rama pritet nga kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Rishi Sunak.

### 17 FOKUS

- Zgjedhjet lokale, Ambasadorja Yuri Kim takohet me dre-

jtuesit e tre forcave politike.

### 18 RAJONI

-A mund të sigurojë Brukseli një paqe të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor?

- Milo Gjukanoviç: Neglizhenca e BE-së i dha Rusisë hapësirë në Ballkanin Perëndimor.

### ENGLISH EDITION

### 23 REALPOLITIK

- “Blank Paper” in the White House! Enough is enough! Euro – Atlantic routine! Cold Halva! Alliance, no Chinese impartiality! Pantings and boats!

### 22 ENGLISH TOP NEWS

- Joint press statement following the 12th meeting of the EU-Albania Stabilisation and Association Council.

### 26 IN FOCUS

- Europe is awake, united and more valuable than ever before.

### 24 BALKAN OVERVIEW

- European Council welcomes the agreement between Belgrade and Pristina reached in Ohrid.

## EKSKLUZIVE

# Ambasadori i Kroacisë në Shqipëri, Z. Zlatko Kramaric: Miqësia, marrëdhëniet tona të mira politike duhet të vërtetohen me veprimtari konkrete, jo me fjalë!”

“ Kur flitet për Kosovën, duhet të jetë e qartë për të gjithë se Kosova është një fakt politik.



## Intervistë Ekskluzive për Argumentum.al me Ambasadorin e Republikës së Kroacisë në Shqipëri SH.T.Z . Zlatko KRAMARIC

Nga MARJANA DODA

**K**a progres në marrëdhëniet ndërmjet Kroacisë dhe Shqipërisë, por ende nuk mjafton, sidomos kur ky bashkëpunim krahasohet me disa vende të tjera. “Miqësia, marrëdhëniet tona të mira politike duhet të vërtetohen me veprimtari konkrete, jo me fjalë!”, kështu thotë Ambasadori i Republikës së Kroacisë në Shqipëri H.E. Z. Zlatko Kramaric në një intervistë ekskluzive për Argumentum.al

Duke i konsideruar pakicat kombëtare si pasurinë e çdo vendi,

ambasadori vlerësoi lartë kontributin e arbanasve/arbëreshëve nga Zadari duke thënë se është i pamatshëm. “Fakti që ata janë të pranishëm në këto zona për më shumë se 200 vjet e vërteton këtë në mënyrën më të mirë të mundshme. Në të njëjtën kohë, ato dëshmojnë për lidhjet afatgjata mes dy vendeve tona. Nuk ka ambasadorë më të mirë se ata”, tha ai. Sipas z. Kramaric, ka synime të sinqerta të Shqipërisë për të përfshirë sa më shumë Kroacinë në procesin e negociatave të anëtarësimit në BE, sepse përvojat e Kroacisë në këtë proces janë të vlefshme dhe mund të ndihmojnë palën shqiptare.

Kur flasim për Kosovën, duhet të jetë e qartë për të gjithë se Koso-

va është një fakt politik, tha ambasadori i cili ishte i mendimit se propozimi franko-gjerman për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës mori mbështetjen e plotë të të gjithë anëtarëve të BE-së, përfshirë ato 5 shtete që nuk e njohën Kosovën. Dhe ata janë të vetëdijshëm se në këtë moment paqja dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor janë më të rëndësishmet. “Unë mendoj se Serbia jo vetëm që do të duhet ta pranojë këtë plan, por edhe ta zbatojë atë, tha ai.

Në lidhje me marrëdhëniet mes Sofjes dhe Shkupit, ndër të tjera, tha se si profesor e shkrimtar ka shkruar disa libra për këto probleme lidhur me marrëdhëniet mes



Sofjes dhe Shkupit. “Ndër të tjera, kam sugjeruar se çështja e gjuhës, kulturës dhe historisë nuk mund të jenë tema në procesin e negociatave. Këto pyetje i përkasin sferës së shkencës, historiografisë, gjuhësisë... Unë e di se ka paqartësi, por jam i vetëdijshëm se rrota e historisë nuk mund të kthehet prapa dhe se kombi, shteti dhe gjuha maqedonase janë fakte të padiskutueshme”, tha kryediplomati i Zagrebit në Tiranë.

I pyetur nëse Ballkani rrezikon rikthimin e një konflikti të hapur, ai tha pas agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, zona e Ballkanit Perëndimor u bë politikisht interesante. Domethënë, gjithçka është ende e hapur këtu.

“Asnjë marrëveshje e vetme (Dajton, Ohër, Kumanovë) nuk ishte plotësisht e suksesshme. Të gjitha këto marrëveshje vetëm sa ngrinin konfliktet ekzistuese. Gjithashtu, nuk duhet të injorojmë ndikimin rus në situatën politike në rajon. Ky ndikim është i dukshëm edhe në Beograd, Podgoricë dhe Republikën e Serbisë... Dhe nuk është sekret. Milorad Dodik, presidenti i Republika Srpska, flet publikisht për këtë, dhe në Serbi ka parti politike pro-ruse, si dhe politikanë që kundërshtojnë çdo ide të një Serbie evropiane, dhe qëndrime të tilla i mundësojnë Vuçiçit të ulet në dy (dhe më shumë) karrige”.

#### INTERVISTA E PLOTË:

**Argumentum.al:** I nderuar Ambasador fillimisht më lejoni t’ju falendëroj që pranuat të jepni këtë interviste ekskluzive për Argumentum.al. Si i konsideroni marrëdhëniet aktuale midis Kroacisë dhe Shqipërisë, si politikisht dhe ekonomikisht?

SH.T.Z. Zlatko Kramaric: Duhet

të jemi të sinqertë dhe të themi se ka ende disa paragjykime që ngadalësojnë marrëdhëniet tona politike dhe ekonomike. Detyra ime është të luftoj kundër këtyre paragjykimeve, si këtu në Shqipëri, por edhe në shtëpi, në Kroaci. Ka progres, por ende nuk mjafton. Sidomos kur ky bashkëpunim krahasohet me disa vende të tjera. Miqësia, marrëdhëniet tona të mira politike duhet të vërtetohen me veprimtari konkrete, jo me fjalë! Dhe funksioni i politikës/diplomacisë zbrit në sigurimin e një atmosfere pozitive, duke hequr barrierat e panevojshme, në mënyrë që ekonomitë tona të mund të funksionojnë lirshëm.

**-Ndonëse vitin e kaluar kujtuam 3 dekada të marrëdhënieve tona diplomatike. Duhet thënë se historia e lidhjeve të përbashkëta**

**Kur flitet për Kosovën, duhet të jetë e qartë për të gjithë se Kosova është një fakt politik. Është premisa/pika e fillimit zero e të gjitha marrëveshjeve. Në fund të fundit, ashtu si Bosnja dhe Hercegovina e Dejtonit. Çdo opsion tjetër (korigjimi i kufijve, kërkesa për autonomi territoriale...) paraqet një rrezik të madh. Askush në Evropë nuk ka nevojë për një ndalesë tjetër.**

**midis Shqipërisë dhe Kroacisë i ka rrënjët e hershme, siç është komuniteti shqiptar në Kroaci. Sa e kanë ndihmuar arbëreshët e Zares marrëdhëniet tona dypalëshe?**

Pakicat kombëtare duhet të jenë pasuria e çdo vendi. Jemi krenarë që komuniteti shqiptar në Kroaci është pjesë integrale e shoqërisë sonë. Dhe kjo në të gjitha aspektet e jetës, politike, kulturore, shpirtërore, ushtarake, ekonomike, sportive... Këtu spikasin arbanasit/arbëreshët nga Zadari. Kontributi i tyre në shoqërinë kroate është i pamatshëm dhe fakti që ata janë të pranishëm në këto zona për më shumë se 200 vjet e vërteton këtë në mënyrë më të mirë të mundshme. Në të njëjtën kohë, ato dëshmojnë për lidhjet afatgjata mes dy vendeve tona. Nuk ka ambasadorë më të mirë se ata.

**-Kroacia ka dhënë një mbështetje të pakursyer ndaj Shqipërisë në procesin e afrimit me Bashkimin Evropian, por personalisht vë re se ekziston një ngërç i pakuftueshëm politik në mes dy vendeve tona. Them këtë pasi nuk kam parë një bashkërendim politik ndërmjet qeverive tona. Jemi afër dhe larg njëkohësisht?**

Ke pjesërisht të drejtë. Mund dhe duhet të jetë gjithmonë më mirë. Kemi pasur disa takime së fundmi. Në ato takime u konstatua se ky koordinim mes qeverive tona duhet të institucionalizohet. Mund të them se ka synime të sinqerta për të përfshirë sa më shumë Kroacinë në këtë proces negociator. Së fundi, përvojat tona në këtë proces janë të vlefshme dhe mund të ndihmojnë palën shqiptare.

**-Ambasador ju i njihni mire**

**vendet e Ballkanit Perendimor, edhe si diplomat pasi keni qenë Ambasadori i Kroacisë në Republikën e Kosovës, në Maqedoninë e Veriut, Konsulli i Përgjithshëm i Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe aktualisht jeni ambasador i Kroacisë në Tiranë. Çfarë na ndan e na bashkon në këndvështrimin tuaj ndërmjet njëri-tjetrit?**

Të gjitha destinacionet e mia diplomatike (Kosova, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria...) janë po aq interesante dhe sfiduese. Unë kam qenë ambasadori i parë kroat në Kosovë menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës; natyrisht, se me këtë akt, Kroacia deklaroi pa mëdyshje qëndrimin e saj ndaj këtij fakti të ri politik në rajon; Maqedonia është dashuria ime e vjetër profesionale, kështu që në atë vend kam mundur të kombinoj të këndshmen me të dobishmen; Marrëdhëniet politike në Bosnje/Republika Srpska janë jashtëzakonisht të rëndësishme për shkak të komunitetit kroat në atë vend, për shkak të kufirit të gjatë dhe Shqipëria përfaqëson një potencial të madh politik dhe ekonomik, i cili nuk njihet dhe përdoret sa duhet. Nëse një Milan Sufflay, gati njëqind vjet më parë, e pranoi rëndësinë e çështjes shqiptare në marrëdhëniet gjeopolitike evropiane, atëherë duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë rëndësi sot (shpresoj që në mandatin tim në parkun qendror të qytetit, të arrij të vendos një bust atij shkencëtari dhe mikut të madh të Shqipërisë).

Thuhet se mandatet diplomatike janë të kufizuara, sepse pas një kohe diplomatët dashurohen me vendin ku shërbejnë, ndaj bëhen jokitikë në vlerësimet e tyre. Kjo është e vetmja arsye pse mandatet tona janë të kufizuara. Kështu

unë, në secilin prej vendeve ku kam qenë, jam përpjekur të shoh vetëm të bukurën, nga zakonet e reja dhe të ndryshme, folklori, kultura, ushqimi, muzika, vende të bukura dhe interesante, duke folur me botën e zakonshme... mësoni diçka të re dhe, natyrisht, në raste të tjera të ktheheni në të gjitha ato vende si një turist i informuar!

Duke qenë se jam edhe shkrimtar, mbaj rregullisht ditarët e mi, të cilët do t'i botoj një ditë. Prandaj, më lejoni të mos veçoj ndonjë destinacion në veçanti: të gjithë janë po aq interesantë!

**-Z. Kramaric cili është mendimi juaj për dialogun e sponsorizuar nga BE dhe SHBA për të normalizuar marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë? Çfarë mendoni për propozimin franko-gjerman. A do të kemi një marrëveshje mes Prishtinës dhe Beogradit?**

Kur flitet për Kosovën, duhet të jetë e qartë për të gjithë se Kosova është një fakt politik. Është premisa/pika e fillimit zero e të gjitha marrëveshjeve. Në fund të fundit, ashtu si Bosnja dhe Hercegovina e Dejtonit. Çdo opion tjetër (korrigjimi i kufijve, kërkesa për autonomi territoriale...) paraqet një rrezik të madh. Askush në Evropë nuk ka nevojë për një ndalesë tjetër. Së fundi, ky propozim për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës mori mbështetjen e plotë të të gjithë anëtarëve të BE-së, përfshirë ato 5 shtete që nuk e njohën Kosovën. Dhe ata janë të vetëdijshëm se në këtë moment paqja dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor janë më të rëndësishmet.

Mendoj se Serbia jo vetëm që do të duhet ta pranojë këtë plan, por

edhe ta zbatojë atë. Dhe të gjithë elementët e tij. Deklaratat e liderëve evropianë janë më se të qarta. Është koha që marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës të normalizohen. Ky do të ishte një mesazh i mirë edhe për aktorët e tjerë politikë në rajon. mbi të gjitha, atyre në Beograd, Banja Luka dhe Mal të Zi, të cilët ende mendojnë se mund t'i sabotojnë këto procese pozitive. Dhe së fundi, pyetja e të gjitha pyetjeve: ku janë qytetarët e Kosovës në gjithë këtë, pa dallim kombësie?!

**- Ndonëse një vit më parë u hapen negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, ecuria e RMV-së është ende përballë kushtëzimit bullgar. Si njohës i mirë i këtij vendi a mendoni se do të sakrifikojë RMV edhe gjuhën, kulturën dhe historinë përveçse emrit të saj? Kush ka të drejtë në këtë përplasje historike ndërmjet dy vendeve?**

Nuk e di nëse e dini se unë jam profesor universitar i letërsisë dhe kulturës maqedonase, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, prandaj jam apriori dëshmitar jo i besueshëm. Kam shkruar disa libra për këto probleme lidhur me marrëdhëniet mes Sofjes dhe Shkupit, në të cilët, ndër të tjera, kam sugjeruar se çështja e gjuhës, kulturës dhe historisë nuk mund të jenë tema në procesin e negociatave. Këto pyetje i përkasin sferës së shkencës, historiografisë, gjuhësisë... Unë e di se ka paqartësi, por jam i vetëdijshëm se rrota e historisë nuk mund të kthehet prapa dhe se kombi, shteti dhe gjuha maqedonase janë fakte të padiskutueshme. Zgjidhja e kësaj mosmarrëveshje politiko-emosionale duhet kërkuar në dialog, në gjithëpërfshirje.



Ambasadori i Kroacisë  
SH.T.Z. Zlatko KRAMARIC

*Së shpejti presidenti shqiptar do të bëjë një vizitë zyrtare në Kroaci. Është një mesazh i shkëlqyer dhe domethënës për të gjithë, përfshirë ata në rajon, por edhe për të gjithë të tjerët.*

Një filozofi që bazohet në parimin ose nuk është e mirë, ose asnjë problem nuk mund të zgjidhet me të! Megjithatë, kjo është vetëm një dëshmi më shumë se në këto zona të gjitha kombet vuajnë nga “teprica e historisë”!

**– Agresioni ushtarak rus kundër Ukrainës solli pasiguri në Evropë dhe në Ballkan. Sot një vit më pas a rrezikon Ballkani rikthimin e një konflikti të hapur nisur edhe nga disa mosmarrëveshje që shkaktojnë herë pas here trazira si në Kosovë, Mali i Zi dhe Bosnjë e Hercegovinë?**

Ke shumë të drejtë. Pas agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, zona e Ballkanit Perëndimor bëhet politikisht interesante. Domethënë, gjithçka është ende e hapur këtu. Asnjë marrëveshje e vetme (Dajton, Ohër, Kumanovë) nuk ishte plotësisht e suksesshme. Të gjitha këto marrëveshje vetëm sa ngrinë konfliktet ekzistuese. Gjithashtu, nuk duhet të injorojmë ndikimin rus në situatën politike në rajon. Ky ndikim është i dukshëm edhe në Beograd, Podgoricë dhe Republikën e Serbisë... Dhe nuk është sekret. Milorad Dodik, presidenti i Republika Srpska, flet publikisht për këtë, dhe në Serbi ka parti politike pro-ruse, si dhe politikanë që kundërshtojnë çdo ide të një Serbie evropiane, dhe qëndrime të tilla i mundësojnë Vuçiqit të ulet në dy (dhe më shumë) karrige.

Për më tepër, në mediat tuaja vëmendje i është kushtuar Kishës Ortodokse Serbe. Është një organizatë politike par excellence, e cila ka lidhje të mëdha me Kishën Ortodokse Ruse. Po kështu, duhet të kemi parasysh se politika serbe nuk ka hequr dorë nga projekti i Serbisë së Madhe. Megjithatë, tani ai projekt fshihet pas frazës së pafajshme ‘bota serbe’, e cila është

vetëm një emër tjetër për strategjitë e vjetra politike perandorake. Prandaj, zgjedhjet e fundit presidenciale në Mal të Zi janë shumë të rëndësishme. Fitorja e M. Gjukanoviçit do të ishte një shenjë e mirë se Mali i Zi është ende në rrugën evropiane dhe se nuk heq dorë nga vlerat evropiane.

**– Pushtimi rus i Ukrainës shihet si një kërcënim për rendin gjeopolitik. Shumë analistë thonë se rendi botëror nuk do të jetë më si më parë. A keni ju një parashikim se si do të përfundojë kjo luftë?**

Kohët e fundit pata rastin të lexoj artikullin e shkëlqyer të Paul Mason ‘Misjudgment’, ku ky autor e shtjellon me mjeshtëri pikërisht këtë tezë tuajën për ndryshimin e rendit botëror, i cili u vendos pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945. Rusia me ndihmën e Kinës, mos harroni se liderët rusë dhe kinezë u takuan vetëm disa ditë para fillimit të agresionit rus. Me atë rast ata publikuan një deklaratë të përbashkët në të cilën ndër të tjera thuhet se projekti global është trillim, se të drejtat universale nuk ekzistojnë më. Dhe që atëherë kemi përpjekjen e këtyre dy vendeve për të kri-

juar një rend botëror ‘multipolar’ në të cilin forca do të ishte më e fortë se e drejta ndërkombëtare. Ata vendosën të përdorin sistemin e globalizimit ekonomik për të shkatërruar rendin juridik dhe gjeopolitik që i lejoi ata të lulëzojnë!

Sa i përket vlerësimit të përfundimit të luftës, nuk jam shumë optimist. Rusia është e fuqishme dhe Rusia ka armë bërthamore!

**– Për ta përmbyllur këtë interviste me dy vendet tona. Z. Ambasador si Kroacia dhe Shqipëria kanë tregur se janë faktor për paqen dhe stabilitetin në rajonin tonë. Çfarë mund të bëjnë më shumë që këto dy vende të jenë unison përballë kërcënimeve të sigurisë dhe jo vetëm, në Ballkanin Perëndimor?**

Paqja dhe stabiliteti nuk kanë alternativë. Si Shqipëria ashtu edhe Kroacia janë të vetëdijshme për këto fakte.

Së shpejti presidenti shqiptar do të bëjë një vizitë zyrtare në Kroaci. Është një mesazh i shkëlqyer dhe domethënës për të gjithë, përfshirë ata në rajon, por edhe për të gjithë të tjerët. Vendet tona janë anëtarë të aleancës së NATO-s dhe ky është një fakt shumë i rëndësishëm gjeopolitik. Do të ishte e dëshirueshme nëse do të fitonte një rëndësi edhe më të madhe. Ne duhet të gjejmë një mënyrë për ta bërë atë jo vetëm më të dukshme, por që ky fakt përfaqëson pikënisjen e të gjitha marrëdhënieve tona të tjera, në fushën e ekonomisë, energjisë, lidhjeve më të mira të transportit, turizmit, sigurisë... të bindur se presidentët tanë do të hapin pikërisht këto tema, të cilat më pas do të funksionalizohen në nivel qeveritar.



# Ambasadori i Kinës Z. Zhou Ding mbyll mandatin e tij në Shqipëri: Miqësia tradicionale e dy popujve tanë është thesari i përbashkët dhe themeli për zhvillimin afatgjatë të marrëdhënieve dypalëshe



**A**

mbasadori i Kinës në Shqipëri, Z. Zhou Ding njoftoi për mbylljen e mandatit të tij në Shqipëri duke theksuar miqësinë tradicionale midis dy vendeve si themel për zhvillimin afatgjatë të marrëdhënieve dypalëshe

Kinë-Shqipëri.

Zhou Ding bëri një bilanc të shkurtër të disa prej aktiviteteve kryesore gjatë mandatit të tij në Shqipëri.

*“Ne zhvilluam së bashku një sërë aktivitete për të festuar 70 vjetorin e themelimit të marrëdhënieve diplomatike mes Kinës dhe Shqipërisë. Shijuar së bashku fenerë kineze, këngë dhe valle kineze, ushqime kineze në sheshin Skënderbej, mbollëm pemën e miqësisë kino-shqiptare në Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës, u përballëm me sfidat e tërmetit të vitit 2019 dhe COVID-19 që pasoi, dhe patëm nderin të bëjmë donacione bamirësie në emër*

*të qeverisë kineze për komunitete dhe organizata në të gjithë Shqipërinë”, shkruan në një postim në rrjetin social facebook ambasadori Zhou Ding.*

Gjatë këtij mandati të Ambasadorit Zhou Ding ndër të tjera u arritën dy marrëveshje të rëndësishme midis Kinës dhe Shqipërisë si Marrëveshja për Heqjen Reciproke të Vizave midis dy vendeve dhe “Memorandumin e mirëkuptimit për bashkëpunimin turistik ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Republikës Popullore të Kinës dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Republikës së Shqipërisë”.

**Argumentum.al sjell mesazhin e plotë të ambasadorit të Kinës në Shqipëri Z. Zhou Ding:**

Të dashur miq,

Unë do të përfundoj së shpejti mandatin tim si Ambasador i Kinës në Shqipëri, t’i jap lamtumirën vendit të bukur të shqiptonjave dhe të kthehem në

Pekin. Ditët e fundit u takova me Presidentin Begaj, Kryeministrin Rama, Kryetaren e Kuvendit Nikola dhe personalitete të tjera shqiptare. I falenderova për mbështetjen e tyre të çmuar për kryerjen e detyrave të mia dhe shkëmbyem mendime të thella mbi marrëdhëniet kino-shqiptare dhe bashkëpunimin me interes të përbashkët midis dy vendeve. Për shkak të kohës së kufizuar, nuk mund t'ju takoj dhe t'ju them lamtumirë një nga një. Katër vjet e dy muaj që kam shërbyer si Ambasador në Shqipëri, është përvoja e rëndësishme dhe e paharrueshme në karrierën time diplomatike. Ju falënderoj sinjerisht për kujdesjen dhe mbështetjen, përfshirë edhe ata që nuk më kanë takuar kurrë, por gjithmonë mbështesin punën e Ambasadës Kineze dhe marrëdhëniet kino-shqiptare.

Gjatë këtyre katër viteve, marrëdhëniet kino-shqiptare kanë ruajtur zhvillim të qëndrueshëm. Të dyja vendet kanë mbajtur ndërveprime të mira të nivelit të lartë. Vëllimi tregtar dypalësh është rritur vit pas viti. Marrëveshjet për heqjen reciproke të vizave, bashkëpunimin për eksporte të produkteve bujqësore në Kinë dhe turizmin janë nënshkruar. Disa projekte të bashkëpunimit praktik janë nisur njëri pas tjetrit. Shkëmbimet kulturore dhe njerëzore janë bërë gjithnjë e më aktive. Jam thellësisht i nderuar që mora pjesë dhe të kontribuova për arritjet e sipërmendura. Gjatë këtyre katër viteve, duke ruajtur komunikimin e ngushtë dhe prom-

ovuar në mënyrë aktive bashkëpunimin me qeverinë qendrore, pushtetet vendore dhe kuvendin e Shqipërisë, kam vizituar gjithashtu komunitete, universitete dhe ndërmarrje në Shqipëri, ku kam pasur ndërveprime të sinqerta me miqtë shqiptarë. Ne zhvilluam së bashku një sërë aktivitetesh për të festuar 70 vjetorin e themelimit të marrëdhënieve diplomatike mes Kinës dhe Shqipërisë. Shijua së bashku fenerë kinezë, këngë dhe valle kineze, ushqime kineze në sheshin Skënderbej, mbollëm pemën e miqësisë kino-shqiptare në Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës, u përballëm me sfidat e tërmetit të vitit 2019 dhe COVID-19 që pasoi, dhe patëm nderin të bëjmë donacione bamirësie në emër të qeverisë kineze për komunitete dhe organizata në të gjithë Shqipërinë. Shumë momente të bukura do të mbeten në zemrën time.

“Sado larg nga miqtë që jemi, porsì komshi të mirë i kemi”. Kina e ka konsideruar gjithmonë Shqipërinë si një mik dhe partner, zhvillimi i vazhdueshëm i Kinës do të ofrojë më shumë mundësi për Shqipërinë. Miqësia tradicionale e gjatë midis Kinës dhe Shqipërisë është thesari i përbashkët i të dy popujve dhe themeli për zhvillimin afatgjatë të marrëdhënieve dypalëshe. Nuk do t'i harroj kurrë historitë prekëse të ndërveprimeve qoftë personale qoftë familjare, mes kinezëve dhe miqve shqiptarë, të moshave të ndryshme dhe kudo në Shqipëri. U preka thellësisht nga pritshmëria e tyre për të

trashëguar miqësinë dhe marrëdhëniet kino-shqiptare, dhe jam besimplot për të ardhmen e marrëdhënieve kino-shqiptare.

Duke dhënë lamtumirën tokës ku kam punuar dhe jetuar, zemra ime nuk mund të qetësohet për kohë të gjatë. Shqipëria është plot sharm dhe ka potencial të madh zhvillimi. Historia e gjatë, dielli i ndritshëm dhe peizazhet e bukura, veçanërisht vitaliteti dhe qëndrueshmëria, çiltërsia dhe mikpritja e popullit shqiptar, më kanë lënë një përshtypje të paharrueshme. Unë do të largohem me miqësinë tuaj të thellë. Pavarësisht ku do të jem në të ardhmen, gjithmonë do t'i kushtoj vëmendje marrëdhënieve kino-shqiptare dhe gjithmonë do të jem një misionar i miqësisë kino-shqiptare. Unë sinjerisht uroj prosperitet për Kinën dhe Shqipërinë, uroj që miqësia midis dy vendeve tona të zgjasë përgjithmonë!





# Takimi i 12-të i Këshillit të Stabilizim-Asociimit në Tiranë, BE: Shqipëria progres në reforma. Duam të zbatojmë në Shqipëri 10 projektet kryesore

**Konferenca e përbashkët me Zëvendës-presidentin e Komisionit Evropian, Josep BORRELL dhe Komisionerin për Zgjerimin, Oliver VARHELYI**



**K**ëshilli i Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri (Këshilli SA) zhvilloi sot takimin e tij të dymbëdhjetë në Tiranë. Mbledhja e Këshillit të Stabilizim Asociimit mes BE dhe Shqipërisë u mbajt për herë të parë në vendin tonë.

Takimi u kryesua nga Josep Borrell Fontelles, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë. Oliver Verhelyi, Komisioneri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin, përfaqësoi Komisionin Evropian. Edi Rama, kryeministër, kryesonte delegacionin shqiptar. Morën pjesë edhe

ministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme, Olta Xhaçka dhe ministrja e Shtetit dhe Kryenegociatorja, Majlinda Dhuka.

Pjesëmarrësit përshëndetën drejtimin dhe ambicien e qartë strategjike të Shqipërisë në BE për të ecur përpara në negociatat e anëtarësimit, bazuar në progresin e reformave, duke riafirmuar angazhimin e BE-së për të mbështetur më tej Shqipërinë në përpjekjet e saj drejt anëtarësimit në BE. Pjesëmarrësit nënvizuan gjithashtu rëndësinë e avancimit të mëtejshëm të progresit të reformës dhe konsolidimit të zbatimit, në interes të

qytetarëve të Shqipërisë.

Kreu i qeverisë tha se vendi ynë nuk është në fund të trenit të integritit, por në krye të rajonit. Rama dha shpresa se Shqipëria mund të integrohet në BE brenda kësaj dekade, por ka ende shumë detyra për të plotësuar. Shefi i diplomacisë, Borrell tha se lufta në Ukrainë tregoi frymën europiane të Shqipërisë, e cila veprimi në të njëjtën linjë me politikën e jashtme të BE-së.

Komisioneri i Bashkimit Evropian për Fqinjësinë dhe Zgjerimin, Oliver Verhelyi deklaroi sot se, “kemi dhënë 1.8 miliard euro

grante për zbatimin e 40 projekteve kryesore në Ballkanin Perëndimor”.

Komisioneri Varhelyi tha se, “duam të zbatojmë në Shqipëri 10 projektet kryesore”.

“Kjo është arsyeja pse tashmë është kaq e rëndësishme që të përshpejtojmë realizimin e këtij plani, sa më shpejt ta realizojmë, aq më shpejt do të jemi në gjendja ta përshpejtojmë zhvillimin e ekonomive që janë këtu dhe aq më shpejt do të jemi në gjendje që të bindim investitorët e huaj të drejtpërdrejtë që të vijnë gjithmonë e më tepër në më shumë numra”, tha Varhelyi.

“Vitin e kaluar kemi parë që shifrat kanë qenë të mira, por ne duam të kemi më shumë sesa kaq. Për këtë arsye, kemi dhënë 1.8 miliardë euro grante për zbatimin e 40 projekteve kryesore në Ballkan, por na duhet të shkojmë përtej. Na duhen lidhje tregtare që do të thotë rrugë e hekurudha, ndërlidhje digjitale, na duhet siguria energjetike dhe na duhet më shumë energji për Ballkanin Perëndimor. Këto janë tema që ne gjithashtu përmendëm. Po kështu, pamë edhe 10 projektet kryesore që duam të zbatojmë në Shqipëri dhe me Shqipërinë. Deri më tani, kemi arritur që të ofrojmë në grante dhe në hua pak më shumë se gjysmë miliardi euro për Shqipërinë, vetëm gjatë 3 viteve të fundit”, tha ai.

*Takimi u pasua mes një konferencë për shtyp mes Ramës dhe zyrtarëve të lartë, të cilët mbajtën edhe njëherë qëndrimin e qartë se vendi i Shqipërisë është në BE.*

Argumentum.al, sjell tematikat kryesore që u trajtuan në konferencën për shtyp:

Komisioneri Oliver Varhelyi

**Kjo është arsyeja pse tashmë është kaq e rëndësishme që të përshpejtojmë realizimin e këtij plani, sa më shpejt ta realizojmë, aq më shpejt do të jemi në gjendja ta përshpejtojmë zhvillimin e ekonomive që janë këtu dhe aq më shpejt do të jemi në gjendje që të bindim investitorët e huaj të drejtpërdrejtë që të vijnë gjithmonë e më tepër në më shumë numra.**



## DREJTËSIA

Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë/zëvendës-president i Komisionit Evropian, Josep Borrell e cilësoi sot mbajtjen në Tiranë të takimit të 12-të të Këshillit të Stabilizim-Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, mundësi dhe ditë të veçantë.

“Sot është një mundësi e veçantë dhe ditë e veçantë, sepse faktikisht është herë e parë në historinë e marrëdhënive tona midis Shqipërisë dhe BE, që ne e mbajmë këtë Këshill në Tiranë. Këto takime dhe mbledhje të

rëndësishme vjetore mbahen zakonisht në Bruksel ose Luksemburg, por sot jemi këtu në Tiranë për t’i treguar popullit shqiptar që Shqipëria po i afrohet gjithmonë e më tepër pranë jush. Me këtë ne duam të japim një sinjal të fuqishëm politik për angazhimin e BE-së ndaj rrugëtimit shqiptar si anëtar i BE-së. Faktikisht e përdorimi Këshillin e Stabilizim-Asociimit si ndërveprimin institucional më të rëndësishëm ndërmjet BE dhe Shqipërisë”, tha Borrell në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin Edi Rama dhe Komisionerin për Fqinjësinë dhe Zgjerimin në



BE, Oliver Varhelyi, në kuadër të mbledhjes së dymbëdhjetë midis BE-së dhe Shqipërisë për Këshillin e Stabilizim-Asociimit.

Ai theksoi se, “përmes këtyre takimeve ne marrim në konsideratë përparimin lidhur me përgatitjet për anëtarësim, shqyrtojmë çfarë është bërë, diskutojmë ku ka nevojë për më tepër përpjekje dhe çfarë pune kemi ende përpara nesh. Mesazhi kryesor nga kjo mbledhje e këtij Këshilli

qartë që ky vend ka treguar një angazhim të fuqishëm ndaj reformave të nevojshme dhe ka arritur etapa të rëndësishme veçanërisht në fushën e drejtësisë, ku Shqipëria ka zbatuar një reformë rrënjësore në drejtësi, e cila ka ecur përpara në mënyrë të qëndrueshme. Kjo është një mundësi e qartë për të ecur më tej përpara”, theksoi Borrell.

“Institucionet shqiptare duhet të përshpejtojnë reformat duke u

jemi përgjigjur shpejt pas sulmit masiv kibernetik gjatë verës së shkuar. Kemi përfshirë të gjithë partnerët dhe vendet e Ballkanit Perëndimor në politikën tona për zbutjen ndikimit negativ të luftës ruse kundër Ukrainës”, theksoi Borrell.

## ENERGJIA & GAZI

Në fjalën e tij, në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin Edi Rama, dhe përfaqësuesin e Lartë të BE për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Josep Borrell, Komisioneri Varhelyi theksoi se, “Shqipëria u ngrit më e fuqishme nga këto momente kritike pas tërmetit dhe pandemisë”.

Ai tha se, “Shqipëria do të jetë e para që do të realizojë një terminal të gazit të lëngshëm natyror”.

“Në qoftë se do të ktheja kokën pas, më kujtohet shumë mirë dita e parë në detyrë dhe ishte dita e tërmetit në Durrës dhe në rrethinë. Më kujtohet më pas COVID-i që erdhi menjëherë më pas dhe më kujtohet sa të hidhëruar ishim sëbashku me kryeministrin dhe jam shumë i lumtur të shoh që Shqipëria i ka tejkaluar këto pengesa. Shqipëria u ngrit më e fuqishme nga këto momente kritike. BE-ja ka qenë gjithmonë krah Shqipërisë edhe gjatë këtyre krizave ne do të jemi krah Shqipërisë sepse tashmë energjia është kriza e re. Kjo është arsyeja pse kemi dhënë 1 miliard euro në paketën mbështetëse të energjisë. Elementet e para sapo do të mbërrijnë. Zëvendës Presidenti dhe Përfaqësuesi i Lartë e përmendi, 80 milion euro në mbështetje në formë granti e në formë mbështetje buxhetore për Shqipërinë, por kjo nuk do të jetë mjaftueshëm pasi na duhet një sistem më rezistent



është angazhimi jonë i patundur për integrimin evropian të Shqipërisë. Ne shohim dhe mirëpresim drejtimin strategjik të qartë të Shqipërisë drejt BE-së. Ne po punojmë së bashku për integrimin e Shqipërisë në të gjitha linjat, që nga negociatat për anëtarësim, tek nisma konkrete, si pjesëmarrja juaj në misionet e politikës sonë të përbashkët për sigurinë dhe mbrojtjen apo Akademinë Diplomatike Evropiane, të cilën e kam prezantuar vitin e shkuar”.

“Dua të pranoj dhe të vlerësoj

bazuar në mbështetjen masive të popullit shqiptar për integrimin evropian. Patëm mundësi të mirëpresim vendimin e kryeministrit Rama që nuk do të bëhet miratimi i pasaportave të arta”, tha ai.

“Po punojmë për një sërë veprimesh për të ndihmuar përf forcimin e aftësisë ripërtëritëse të Shqipërisë ndaj kërcënimeve hibride, në fushën e sigurisë kibernetike, manipulimit të informacionit dhe mbrojtjes së infrastrukturës kritike. Ne kemi marrë veprimet të shpejta dhe



e sovran energjetik për Ballkanin Perëndimor e Ballkani Perëndimor mund të shndërrohet në pikën e re hyrëse të energjisë për Evropën. Po punojmë së bashku. Shqipëria do të jetë e para që do të realizojë një terminal të gazit të lëngshëm natyror. Ne po kështu, po shohim nevojën për të sjellë më shumë gaz në kontinent dhe diskutuam sesi Evropa të mund të lidhet me atë projekt për shembull, me ndërtimin e asaj hallke që mungon”, tha Komisioneri.

Po ashtu, Komisioneri tha se, diskutuam edhe temat që diskutuam në samitin e kaluar.

Terminali evropian i gazit të lëngshëm natyror për Ballkanin sepse kjo është përpjekja tjetër madhore që do të realizohet.

“Natyrisht, këto zhvillime duhet ta sjellin ndryshimin në terren, sepse këtë po e bëjmë që të ndryshojmë realitetet në terren për njerëzit e po kështu dhe për bizneset. Në bazë të kësaj, do të nisë rajoni të rritet më shpejt, e parashtoj edhe më shpejt sesa Bashkimi Evropian sepse ka një potencial të jashtëzakonshëm. Kjo është arsyeja pse jam i inkurajuar nga përkushtimi e dedikimi që shoh nga ana e qeverisë shqiptare sepse shoh që po punojnë pareshtur për të ecur përpara me agjendën e BE-së”, tha Komisioneri Varhelyi.

### **PASAPORTAT E ARTA DHE AMNISTIA FISKALE**

Në konferencën e përbashkët për shtyp, në Tiranë, me dy zyrtarët e lartë të BE-së, Rama u ndal te amnistia fiskale, ndërsa theksoi se, qëndrimi i qeverisë shqiptare për këtë çështje është i ditur.

“Ne vlerësojmë shumë angazhimin e Komisionit dhe të delegacionit për të na ofruar eksper-

tizë. Duam të vazhdojmë punën me ekspertët. Nuk heqim dorë, thjesht sepse kjo nuk është një gjë e mirë në parim, sepse ne kemi të gjitha arsyet tona për të menduar që kjo është gjëja e duhur për Shqipërinë”, tha ai.

Por, kryeministri theksoi se, “nga ana tjetër ne duam që këtë gjë ta bëjmë së bashku dhe prandaj ju falënderojmë për ekspertizën dhe duam t’i shkojmë deri në fund procesit të dialogut edhe të përmirësimit të drafteve”.

Sipas tij, “sot është një draft komplet tjetër nga ajo që ishte në fillim, falë ekspertizës që BE ka ofruar”.

Duke folur për çështjen e kanabisit mjekësor, Rama informoi se, “kemi përfunduar gjithë procesin e konsultimit për këtë, kështu që do të vazhdojmë në parlament, duke pasur shumë të qartë, jo vetëm se si e shkruajmë, por edhe se si e zbatojmë”.

“Për këtë gjithë elementet e monitorimit janë mirëmenduar, por sigurisht do të gjykohet në praktikë”, tha ai.

Për sa i përket pasaportave të arta e kemi bërë të qarë se e kemi pezulluar procesin deri kur të sqarohet në nivel evropian qëndrimi. Ne nuk e shpikëm këtë, e morëm nga vendet e BE-së, që e kanë zbatuar me sukses. Ka një çështje në Gjykatën Evropiane. Ne nuk do ta nxjerrim më këtë iniciativë në tavolinë, pa parë si do të përfundojë çështja në Gjykatën Evropiane”, tha Rama.

Kryeministri u shpreh se, “nëse Gjykata Evropiane do të vendosë kundër pasaportave të arta, kjo është një çështje e mbyllur”.

“Nëse do të vendosë pro, atëherë

çdo vend do të bëjë zgjedhjen e vetë”, theksoi ai.

Nga ana e tij Borrell mirëpriti deklaratën e kryeministrit që skema e pasaportave të arta nuk do të ndiqet më tej.

BE rikujtoi gjithashtu rëndësinë e Paketës së Mbështetjes së Energjisë prej një miliard euro për Ballkanin Perëndimor (500 milionë grante dhe 500 milionë kredi të buta dhe garanci), nga të cilat 80 milionë euro për Shqipërinë synojnë mbrojtjen e grupeve më të cenueshme, të prekura nga krizat energjetike, në veçanti bizneset, familjet dhe NVM-të duke avancuar tranzicionin, sigurinë dhe diversifikimin e energjisë.

BE përshëndeti ratifikimin e fundit nga Shqipëria të Marrëveshjes së Partneritetit të Kornizës Financiare për IPA III. BE përsëriti angazhimin e saj për të ndihmuar Shqipërinë në intensifikimin e punës së reformave, duke përfshirë ato që kërkohen për të maksimizuar ndikimin e Planit Ekonomik dhe Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Në tre vitet e fundit Shqipëria ka marrë 229,1 milionë euro grante dhe 305,1 milionë euro kredi në kuadër të Planit Ekonomik dhe të Investimeve.

Pjesëmarrësit mirëpriten gjithashtu angazhimin e vazhdueshëm konstruktiv të Shqipërisë në bashkëpunimin rajonal si dhe dialogun e saj të vazhdueshëm për të siguruar marrëdhënie të mira fqinjësore. BE-ja kujtoi se bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës siç është identifikuar në planin e veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal do të mbetet vendimtar për të përfituar plotësisht nga potenciali i rajonit dhe nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve.

# 15 vite nga “Gërdeci”/ Humbën jetën 26 persona, u plagosën 300 të tjerë



**15** vite më parë, në 15 mars, 26 persona humbi jetën në një nga ngjarjen më tragjike në vend, si pasojë e shpërthimit të fabrikës së municioneve në Gërdec.

300 qytetarë të tjerë mbetën të plagosur nga shpërthimi që shkatërroi banesat në zonë.

Hetimet për ngjarjen e rëndë janë zvarritur dhe vetëm një dekadë e gjysmë më pas, SPAK ka dorëzuar dosjen në gjykatën anti korrupsion.

Aktualisht Prokuroria e Posaçme ka marrë të pandehur ish ministrin e mbrojtjes të kohës, Fatmir Mediu. Mbi të rëndojnë dy akuza, “Shpërdorimit të detyrës” dhe Shpërdorim i de-

tyrës” mbi bazë të kodit ushtarak.

Në të njëjtën kohë SPAK po kryen hetime në lidhje me korrupsionin e zyrtarëve të lartë dhe pastrimin e parave. Në pyetje janë marrë ish-ministri Aldo Bumçi dhe djali I ish-kryeministrit Berisha, Shkëlzen Beridsha.

SPAK u vu në lëvizje për Mediun, pas kërkesës së prindërve të 7-vjeçarit Erison Durdaj, një prej viktimave të shpërthimit. Më pas SPAK i kërkoi Gjykatës së lartë që të revokonte vendimin e pushimit ndaj Mediut, të marrë në vitin 2009-tën.

Tashmë me këtë vendim dosja në ngarkim të ish-ministrit është në duart e prokurorisë dhe pritet të

gjkohet nga Gjykata e Posaçme. Në vitin 2009-të, Mediu u akuzua nga prokuroria e përgjithshme për shpërdorim detyre dhe shpërdorim detyrë të kryer në bashkëpunim dhe më pas dosja përfundoi në gjykatën e lartë. Por 6 muaj më vonë, gjykata vendosi pushimin e çështjes, pasi Mediu kishte rimarrë mandatin e deputetit, duke rifituar edhe imunitetin që ndalonte gjykatën të vazhdonte gjykimin.

Ish-përgjegjësi i fabrikës së armëve të demontimit që shpërtheu më 15 mars 2008 në Gërdec u dënua me 18 vjet burg, ish-drejtori i MEICO, Ylli Pinari po ashtu me 18 vjet burg, ndërsa administratori i fabrikës Alba-Demil, Mihal Delijorgji me 10 vjet burg.

# Vizita zyrtare e presidentit austriak/ Begaj: Austria mbështet integrimin e Shqipërisë në BE



**P**residenti Bajram Begaj deklaroi se “vizita e presidentit të Austrisë, Alexander Van der Bellen në Tiranë është dëshmi e angazhimit serioz të Austrisë në procesin integruar të Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor si një vend me arritje të shumta në këtë rajon me vëmendje dhe angazhim të vazhdueshëm që rajoni ynë të jetë pjesë e familjes evropiane”.

Në një konferencë të përbashkët për shtyp me homologun austriak, Begaj tha se “kjo vizitë është një tregues i marrëdhënieve të shkëlqyera midis dy vendeve dhe popujve tanë. Marrëdhëniet mes dy vendeve janë të një rëndësie të veçantë. Austria është partner dhe mik historik i Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ndamë pikëpamjen e përbashkët se marrëdhëniet shqiptaro-austriake përjetojnë një klimë të mirë bashkëpunimi dhe se dialogu politik është intensifikuar përfshirë nivelin e vizitave”.

Kreu i Shtetit tha se, “e informova presidentin austriak për përparimin e bërë në zbatimin e reformave në integrimin evropian dhe të rezultateve konkrete në plotësimin e kriterëve në këtë drejtim. I konfirmova vendosmërinë e Shqipërisë për të vijuar me ritme të shpejta angazhimin për të përmbushur të gjitha detyrimet si një vend kandidat për anëtar në BE”.

“E sigurova që Shqipëria mbetet e dedikuar në të gjithë nivelet për rezultate të dukshme në reformën në drejtësi. Brenda kompetencave kushtetuese mbetem tërësisht i angazhuar për mbështetjen e ecurisë së reformës në drejtësi që të gjitha institucionet e larta të drejtësisë të arrijnë standardet e kërkuara nga Bashkimi Evropian, që Shqipëria të forcojë shtetin e të drejtës, garant të cilësisë së demokracisë dhe një sistem drejtësie që gëzon besimin e plotë të shtetasve tanë dhe respekt ndërkombëtar”, nënvizoi Begaj.

Presidenti Begaj tha gjithashtu se “i shpreha mirënjohje për mbështetjen që Austria i ka dhënë vendit tonë për reformën në sistemin e drejtësisë në kuadër të programit EURALIUS nëpërmjet Agjencisë Austriake për zhvillim, Austria do të vijojmë mbështetjen për zhvillimin e këtij aktiviteti. Ndamë bindjen se ekzistojnë mundësi të shumta për zgjerimin e marrëdhënieve ekonomike, rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe të investimeve.

Biseda jonë, natyrisht, kishte në vëmendje çështjen e rrugëtimit evropian të Shqipërisë”.

“I përçolla presidentit Van der Bellen vlerësimin dhe mirënjohjen për të gjithë mbështetjen që Austria i ka dhënë Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit në BE, ku përfshihet mbështetja politike, ekonomike, infrastrukturore e mbi të gjitha mbështetja për reformën në drejtësi. Austria



ka luajtur një rol të rëndësishëm aktiv në mbështetjen e perspektivës evropiane të Shqipërisë; veçanërisht për Konferencën e Parë Ndërqeveritare për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit, e cila përfaqëson një hap të rëndësishëm në kuadrin e avancimit të bisedimeve për integrim evropian midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”, tha Begaj.

Në këtë kontekst, shtoi Begaj, kjo vizitë është gjithashtu, një dëshmi e mëtejshme e angazhimit serioz të Austrisë në proceset integruese të Shqipërisë dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor, si një vend me lidhje të shumta me këtë rajon, me vëmendje dhe angazhim të vazhdueshëm që rajoni ynë të jetë pjesë e familjes evropiane.

Duke folur për Kosovën, Begaj tha se, “shumë e rëndësishme është mbështetja e Austrisë për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare”.

Presidenti Begaj u shpreh se, “vlerësova praninë dhe kontributin e investitorëve austriakë në Shqipëri, në sektorë mjaft të rëndësishëm të ekonomisë me rendësi strategjike si në sektorin bankar, fushën e sigurimeve dhe në sektorin e energjisë si atë të rinovueshme ashtu dhe të energjisë hidrike”.

